

MIRË SE VINI NË QENDRËN TONË TË KUJDESIT DITOR

TË MBROHEMI BASHKËRISHT NGA INFEKSIONET

Udhëzim për prindërit dhe personat tjerë me të drejtë kujdestarie nga ana e institucioneve të përbashkëta në përputhje me dispozitat e nenit § 34 Kryerreshti 5 Rreshti 2 të Ligjit për mbrojtjen nga infeksionet

Në institucionet e përbashkëta, si kopshtet e fëmijeve, shkollat ose kampe pushimesh, ndajmë shumë njerëz së bashku vetëm një hapësirë të kufizuar. Prandaj, këtu sëmundjet infektive edhe mund të përhapen veçanërisht lehtë. Për këtë arsye, Ligji për Mbrojtjen nga infeksionet përmban një numër rregullash që shërbejnë për të mbrojtur të gjithë fëmijët si dhe stafin profesional në institucionet e përbashkëta nga sëmundjet e mundshme infektive. Prandaj ne edhe dëshirojmë të ju informojmë rreth kësaj me këtë fletë informacioni.

1. Ndalimet ligjore për vizitat

Ligji për mbrojtjen nga infeksionet përcakton qartë që një fëmijë nuk mund të shkojë në kopshtin e fëmijëve, në shkollë ose në ndonjë institucion tjetër të përbashkët, nëse i njejtë është i sëmurë nga disa sëmundje infektive të caktuara ose nëse ekziston një dyshimi përkatës për një sëmundje të tillë. Këto sëmundje përkatëse janë të radhitura në Tabelën 1, në faqen në vijim.

Tek disa prej infeksioneve, është e mundur që fëmija juaj të ekskretoj (shpërndajë) patogjenët pas përfundimit të sëmundjes (ose edhe më rrallë: pa pas qenë fare i sëmurë). Prandaj edhe në këtë rast, shokët e lozjes, shokët e klasës ose stafi profesional mund të infektohen nga i njejtë. Prandaj edhe është e paraparë sipas Ligjit për Mbrojtjen nga infeksionet, që „ekskretorët“ (shpërndarësit) e disa bakteleve vetëm me miratimin paraprak të Departamentit të Shën-

detësisë dhe në përputhje me marrjen nën konsideratë të duhur të masave mbrojtëse të përcaktuara me atë rast, mund të shkojnë sërish në një institucion të përbashkët (Tabela 2 në faqen vijuese). Në rastet e disa sëmundjeve infektive veçanërisht serioze, fëmija juaj duhet të qëndrojë në shtëpi qyshe se në rastet nëse një person tjetër në familjen tuaj është i sëmurë ose nëse dyshohet të është ekzistente njëra prej këtyre sëmundjeve infektive (Tabela 3 në faqen vijuese).

Sigurisht se nuk keni pse të jeni vetë në gjendje të njihni sëmundjet e përmendura në vijim. Por duhet të merrni këshilla të duhura mjekësore nëse fëmija juaj ka një sëmundje serioze (p.sh. ethe të lartë, lodhje e dukshme, të vjella të përsëritura, diarre dhe simptoma të tjera të pazakonta ose shqetësuese). Mjeku juaj i fëmijëve / mjekja juaj e fëmijëve do t'ju informojë juve në mënyrë të duhur nëse fëmija juaj ka një sëmundje që ndalon të vizitohet i njejtë një institucion të përbashkët në bazë të Ligjit për mbrojtjen nga infeksionet.

Kundër disa prej sëmundjeve janë të disponueshme edhe vaksinimet. Nëse fëmija juaj është vaksinuar në mënyrë të duhur, atëherë edhe Departamenti i Shëndetësisë mund të te heqë dorë nga lëshimi i ndalimit të vizitave.

2. Detyrimi për njoftim

Nëse ndaj fëmijës suaj ekziston një ndalim vizite për arsyet e përmendura më lart, ju lutemi të na infor-

Ein Kooperationsprojekt von:



Landesverband
Brandenburg e. V.



Unterstützung und finanzielle Förderung:




moni ne menjëherë në lidhje me të tillën dhe për sëmundjen në fjalë. Ju jeni ligjërisht i detyruar të bëni një gjë të tillë dhe njeherit kontriboni në atë mënyrë, që ne së bashku me Departamentin e Shëndetësisë, të ndërmarrim masat e nevojshme kundër përhapjes së mëtejshme të sëmundjes.

3. Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse

Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga infeksionet, institucionet e përbashkëta janë të detyruara me ligjë të japin informacione të duhura rreth opsioneve të përgjithshme për parandalimin e sëmundjeve infektive. Prandaj edhe ju rekomandojmë që ndër të tjera të keni gjithashtu kujdes që fëmija juaj të respektojë rregullat e përgjithshme të higjienës. Mbi të gjitha, kjo përfshin para së gjithash edhe larjen e rregullt të duarve para ngrënies se ushqimit, pas përdorimit të

tualetit ose pas aktiviteteve të lira në natyrë.

Po aq e rëndësishme është gjithashtu edhe një vaksinimi i plotë mbrojtës për fëmijën tuaj. Vaksinat pjesërisht janë gjithashtu të disponueshme edhe për sëmundje të tilla, të cilat shkaktohen nga patogjenët e sëmundjeve në ajrin që thithim dhe prandaj edhe të cilat nuk mund të parandalohen me higjienën e përgjithshme (për shembull, fruthi, shytat dhe lia e dhenve). Informacione të mëtejshme në lidhje me vaksinimet mund të gjeni në:

 www.impfeninfo.de.

Për ndonjë pyetje tjetër që keni, ne ju lutemi të ju drejtohuni mjekut tuaj/mjekes suaj të familjes ose mjekut tuaj/mjekes suaj të fëmijëve ose Departamentit të Shëndetësisë i cili është kompetent për Ju. Gjithashtu edhe ne ju ndihmojmë me gjithë dëshirë tutje.

Tabela 1 Ndalimi i vizitave në objektet e përbashkëta dhe detyra e personave me të drejte kujdestarie për të njoftuar qendrat nëse dyshojnë në pranishmërin e sëmundjes ose janë të sëmurë nga sëmundjet e mëposhtme

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> > liken ngjitëse te lëvores (Impetigo contagiosa) > tuberkulozi ngjitës i mushkërive > dizenteria bakteriale (shigellosis) > Kolerë > Inflamacion i zorrëve (enteritit) i shkaktuar nga EHEC > Difteri > Verdhëz e shkaktuar nga viret e hepatitit A ose E / Inflamacion i Mëlqisë (Hepatiti A ose E) > Meningjiti i shkaktuar nga bakteret Hib > më infektive, d.m.th. diarre dhe / ose të vjella të shkaktuara nga viruse ose baktere (vlen vetëm për fëmijët nën 6 vjeç) > Kolla e mirë (pertussis) | <ul style="list-style-type: none"> > Polio (poliomieliti) > Infektimi me morrat e kokës (nëse trajtimi i saktë nuk ka filluar ende) > Zgjedba (Skabiesit) > Fruthi > Infeksionet e meningokokut > Shytat > Murtajë > Ethet e kuqe ose infeksione të tjera me bakterin Streptococcus pyogenes > Tifoja paratifoja lija e dhenve > (Variçela) ethet hemorragjike të lidhura me virusin (p.sh. Ebola) |
|---|--|

Tabela 2 Vizitat në objektet e përbashkëta vetëm me miratimin paraprak nga ana e Departamentit Shëndetësor si dhe detyra për njoftim e personave me të drejte kujdestarie në rast të ekskretimit (shpërndarjes) të këtyre patogjenëve të sëmundjeve me sa radhiten në vijim

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> > Bakteriet e Kolerës > Bakteriet e difterisë > Bakteriet - EHEC | <ul style="list-style-type: none"> > Bakteret e tifojes- ose të paratifojes > Shigellosis -dizenteria bakteriale |
|---|--|

Tabela 3 Ndalimi i vizitës dhe detyra e njoftimit nga ana e personave me të drejtë kujdestarie nëse dyshojnë në pranishmërin e sëmundjes ose nëse një person tjetër në banesën e përbashkët është i sëmurë nga sëmundjet e mëposhtme

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> > Tuberkulozi ngjitës i mushkërive > dizenteria bakteriale (shigellosis) > Kolerë > Inflamacion i zorrëve (enteritit) i shkaktuar nga EHEC > Difteria > Verdhëz e shkaktuar nga viret e hepatitit A ose E / Inflamacion i Mëlqisë (Hepatiti A ose E) > Meningjiti i shkaktuar nga bakteret Hib | <ul style="list-style-type: none"> > Paraliza e fëmijëve (Poliomieliti) > Fruthi > Infeksionet e meningokokut > Shytat > Murtajë > Tifoja dhe paratifoja e shkaktuar nga virusi > Ethet hemorragjike (p.sh. Ebola) |
|---|--|

